

Shpjegim i "Libri i teuhidit" – 1 (Dobitë e kësaj teme)

(E drejta e Allahut ndaj njerëzve)

Mësime të mbajtura nga dijetari i njohur Salih Ibn Abdul Aziz Muhamed Ali Shejh

(Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët!)

Përkthyes: Bilbil Talla

Redaktor: Ilir Haxhijaj

Lavdërimet i përkasin Allahut, që dërgoi profetët e Tij me mesazhin e teuhidit, që njerëzit të mos kenë justifikime. Të gjithë ata, nga i pari tek i fundit, e njësuan Allahun. Pikëtakimi i të gjithëve ishte veçimi dhe njësimi i Allahut në adhurim dhe heqja dorë nga shirkun. Ai është Allahu i vërtetë, që meriton të adhurohet, e askush tjetër përveç Tij. Adhurimi i kujtdo tjetër është i kotë. Të tjerët adhurohen pa të drejtë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, që është Një dhe pa shok; pohoj dhe ritheksoj këtë, si shprehje e teuhidit. Dëshmoj se Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij. Paqja dhe bekimet e pafundme qofshin me Muhamedin, me familjen e tij dhe me shokët e tij, deri në Ditën e Gjykimit.

Ky libër është i imanit rregullator dhe reformator, shejhut të Islamit dhe muslimanëve Muhamed Ibn Abdul Uhab. Ai nuk ka nevojë shumë të prezantohet, për shkak të gjurmëve dhe dobive të njohura të thirrjes së tij në të gjitha anët e botës, në lindje dhe perëndim, jug dhe veri. E s'kishte si të ndodhte ndryshe, pasi ai - Allahu e mëshiroftë! - ringjalli thirrjen e Profetit tonë Muhamed Ibn Abdullahut, me të qofshin bekimet e Allahut dhe paqja e Tij!

Libri i teuhidit, të cilin po shpjegojmë, është me vlerë të madhe. Të gjithë dijetarët e fushës janë të mendimit se nuk është shkruar libër në lëmin e teuhidit i ngjashëm me të. Ai është unik për temat që trajton. Nuk është përpiluar libër tjetër si ai, pasi autori - Allahu e mëshiroftë! - trajton çështje që kanë të bëjnë me teuhidin në adhurim, me gjërat që bien në kundërshtim me të ose që në zanafillë, ose që bien ndesh me teuhidin e plotë. Kështu, ky libër gëzon epërsinë e trajtimit me detaje dhe argumente të teuhidit në adhurim. Me këtë formë detajimi, renditje dhe ndarje të temave, këtë libër nuk e ka paraprirë asnjë tjetër. Nevoja e nxënësit të dijës për ta lexuar këtë libër dhe për ta kuptuar atë është e ngutshme, për shkak se ai përmban ilustrime me ajete kuranore, me hadithe profetike dhe shtjellim të dobive të përfuara prej tyre.

Disa dijetarë e kanë shëmbëllyer këtë libër me një copë nga libri i Buhariut - Allahu e mëshiroftë! - pasi shejhu e ka përpiluar librin e tij të ngjashëm me *Sahihun* e Buhariut. Temat që trajtohen në këtë libër - në shumicën e rasteve - fillojnë me ajet kuranor dhe hadith. Ajeti dhe hadithi janë tregues të temës dhe

shtjellimet që pasojnë janë treguese të saj, gjithashtu. Po ashtu edhe sjellja e fjalëve të dijetarëve, që nga sahabët, tabi'inët dhe prijësve të diturisë në Islam, është e ngjashme me metodën e ndjekur nga imam Buhariu - Allahu e mëshiroftë! - Kjo pasi ai sjell fjalët e dijetarëve për të sqaruar kuptimet e tekstit. Këtë libër autori, imami i davetit, e nisi ta shkruante pasi shkoi në Basra. Arsyeja e shkrimit të këtij libri ishte se atje ai konstatoi përhapjen e shirkut ndaj Allahut të Madhërishëm dhe humbjen e konceptit të teuhidit të vërtetë tek një pjesë e muslimanëve. Ishin dukuritë e shirkut të madh, të vogël e të fshehtë, që e shtynë të shkruante librin në Basra dhe të shtjellonte treguesit e çështjeve. Këtë e tregon nxënësi dhe nipi i tij, imami Abdurrahman Ibn Hasen, në librin "Mekamate". Pastaj, kur u kthye në Nexhd, Shejhu vijoi me shkrimin e librit dhe e përfundoi atë. Në këtë mënyrë, ai me të drejtë konsiderohet si libri që fton në teuhidin e vërtetë, pasi shejhu tregon në këtë libër argumentet bazë të teuhidit, sqaron kuptimin e teuhidit dhe e shtjellon bukur atë. Po ashtu, ai shtjellon edhe gjërat që bien në kundërshtim me teuhidin, me frikën për gjërat që mund të bien në kundërshtim me të. Ai sqaron, gjithashtu, njësimin e Allahut në adhurim dhe njësimin e Allahut të Madhërishëm në emrat dhe atributet e Tij, në mënyrë të përmbledhur. Ai tregon kujdes për të sqaruar shirkun e madh, të vogël, format e të dyve, dhe rrugët që të çojnë tek ta. Libri sqaron edhe se si mund të ruhet teuhidi, dhe shpjegon përmbledhtazi njësimin e Allahut në krijim. Për këtë arsye, "Kitabu teuhid" është një libër i madh dhe shumë i dobishëm. Ai meriton të gëzojë një përkujdesje të veçantë, të mësohet mirë, të jepet si mësim, të përsiatet rreth tij, pasi njeriu ta mësojë, të punojë me të dhe ta përcjellë diturinë e tij tek njerëzit e tjerë në xhami, në shtëpi, në vendin e punës dhe kudo. Qëllimi është se ai, i cili e kupton këtë libër, ka kuptuar shumicën e çështjeve që kanë të bëjnë me teuhidin në adhurim. Ai madje ka arritur të kuptojë pjesën më të madhe të çështjeve.

Kërkojmë nga Allahu i Madhërishëm të na mbështesë, të na ndihmojë dhe të na japë sukses!

Libri i teuhidit¹

Allahu i Madhëruar thotë:

"Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë."²

¹ *Teuhid* do të thotë ta njësoh Allahun e Lartësuar në adhurim, në krijim dhe menaxhimin e Tij, si dhe në emra dhe attribute. (shënim i përkthyesit)

² DHARIJAT: 56.

"Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): "Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!"³

"Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuroni asgjë tjetër përveç Atij"⁴

"Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)"⁵

"Thuaju: "Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); të silleni mirë me prindërit; të mos vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata; të mos u afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta, dhe të mos ia merrni tjetrit jetën të cilën Allahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia (e ligji). Kështu ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni. Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijë pjekurinë! Kryejeni drejt matjen dhe peshimin; Ne nuk ngarkojmë asgjë përtej mundësisë së tij! Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj! Plotësoni besën e dhënë Allahut! Kështu ju porosit Ai, që të mos harroni. Kjo është rruga Ime e drejtë, prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që ju shmangin nga rruga e Tij. Kështu ju porosit, në mënyrë që të ruheni nga të këqijat."⁶

Ibn Mesudi thotë: "Kush dëshiron të shikojë testamentin e Muhamedit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), mbi të cilin ka vendosur vulën e tij, le të lexojë thënien e Allahut të Madhërishëm: "Thuaju: "Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: të mos i shoqëroni Atij asgjë..." deri: "Kjo është rruga Ime e drejtë ..."⁷

Muadh Ibn Xhebeli tregon: "Isha hipur së bashku me Profetin - paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! - mbi gomar, kur ai më tha: "O Muadh, a e di se cila është e drejta e Allahut ndaj robërve të Tij dhe e drejta e robërve ndaj Tij? - "Allahu dhe i Dërguari Tij e dinë më së miri." – i thashë. Ai tha: "E drejta e Allahut ndaj robërve është ta adhurojnë dhe të mos i bëjnë shok asgjë, ndërsa e drejta e robërve ndaj Allahut është që të mos i dënojnë ata që nuk i bëjnë shok asgjë". Unë e pyeta: "O i Dërguari i Allahut, a t'i përgëzoj njerëzit?" Profeti u përgjigj: "Jo, mos i përgëzo, se pastaj do t'i mbështeten kësaj". Hadithi gjendet në dy *Sahihët*.⁸

³ EN-NAHL: 36.

⁴ ISRA: 23.

⁵ EN-EN-NISA': 36.

⁶ EL-EN'AM: 151-153.

⁷ EL-EN'AM: 151-153.

⁸ Shënon Buhariu: 5967; dhe Muslimi: 30.

Dobitë e temës

- Urtësia në krijimin e xhinëve dhe njerëzve.
- Adhurimi është vetë teuhidi, sepse armiqësia - mes profetëve dhe popujve të tyre - ka ndodhur rreth tij.
- Kush nuk zbaton teuhidin, nuk e ka adhuruar Allahun. Kjo është domethënia e ajetit kuranor: "Dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj"⁹.
- Urtësia e dërgimit të profetëve.
- Mesazhi (Islam) është për çdo popull.
- Feja e profetëve ka qenë e njëjtë.
- Çështja madhore është se adhurimi i Allahut s'mund të arrihet ndryshe veçse duke mohuar *tagutin*. Ky është kuptimi i ajetit kuranor: "Ai që mohon idhujt (dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë"¹⁰.
- Termi *tagut* është i përgjithshëm, që përfshin çdo gjë që adhurohet përveç Allahut.
- Rëndësia e madhe që kishin për selefët tri ajetet e qarta e të prera të sures "El-En'am". Ato ajete trajtojnë dhjetë çështje, e para e të cilave është ndalimi i *shirkut*.
- Ajetet e qarta e të prera të sures "EL-ISRA'" trajtojnë tetëmbëdhjetë çështje të cilat Allahu i fillon me fjalën: "Mos adhuro zot tjetër me Allahun, se do të mbetesh i poshtëruar dhe i braktisur!"¹¹ dhe i mbyll me fjalën e Tij: "Dhe mos adhuro zot tjetër me Allahun, se do të hidhesh në Xhehenem, fajtor dhe i dëbuar." Allahu na e tërheq vëmendjen për rëndësinë e çështjeve të përmendura duke thënë: "Kjo është nga urtësia që ta ka shpallur Zoti yt".
- Ajetin e sures "EN-NISÂ'", që njihet dhe si ajeti i "dhjetë të drejtave", Allahu e fillon me fjalët e Tij: "Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)".
- Kujtimi i porosisë së Profetit - paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të! - në prag të vdekjes.
- Njohja e detyrës që kemi ndaj Allahut.
- Njohja e të drejtës së robërve ndaj Allahut, nëse ata kryejnë detyrën e tyre.
- Këtë çështje nuk e dinin shumica e sahabëve.
- Lejimi i fshehjes së diturisë, kur ka dobi.
- Pëlqyeshmëria e përgëzimit të muslimanit me gjëra të bukura për të.
- Frika se mos njeriu mashtrohet duke iu mbështetur mëshirës së Allahut.

⁹ EL-KAFIRÛN: 3.

¹⁰ EI-EL-BEKARE: 256.

¹¹ EL-ISRÂ': 22.

- Të thënë "Allahu dhe i Dërguari e dinë më së miri" atëherë kur, ai që pyetet, nuk e di përgjigjen.
- Lejimi i dhënies së diturisë vetëm disa njerëzve, duke i veçuar nga të tjerët.
- Thjeshtësia e Profetit - paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të! -, gjë e cila duket në hipjen e tij mbi një gomar bashkë me dikë tjetër.
- Lejimi i qëndrimit me dikë mbi një kafshë.
- Vlera e Muadh Ibn Xhebelit.
- Vlera dhe rëndësia e madhe e kësaj çështjeje.

Thënia e autorit "Libri i teuhidit" dhe thënia e Allahut të Madhëruar "Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë."¹²

Është traditë që shkrimtarët ose autorët e librave, pas "*Bismillah*" dhe "*Elhamdulillah*", të bëjnë një hyrje libri, ku sqarojnë metodologjinë e ndjekur në shkrim dhe qëllimin, por këtu është e drejtë të shtrohet pyetja: Përse shejhu nuk ndoqi metodën e autorëve të tjerë duke mos i bërë librit një hyrje, ku të sqaronte metodën e tij, por tha: "Libri i teuhidit" dhe menjëherë më pas: Allahu i Madhëruar thotë: **"Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë"**? Arsyeja për këtë, siç e mendoj unë, është se teuhidi, të cilin shejhu do të sqarojë në këtë libër, ka të bëjë me Allahun. Teuhidin e ka sqaruar vetë Allahu i Madhërishëm në Kuran, kështu që, në përputhje me edukatën dhe pozitën e teuhidit, autori nuk i bëri librit një hyrje e të shkëpuste të vërtetën, treguesit e saj dhe fjalët që e shprehin këtë të vërtetë. E drejta e Allahut është teuhidi dhe, Ai i cili na e ka treguar këtë të drejtë, është vetë Allahu i Lartësuar, duke u mbështetur te fjala e Tij dhe fjala e të Dërguarit të Tij (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Ky veprim mendjehollë është rezultat i gjurmëve të teuhidit në zemër. Ky veprim është i njëjtë me atë të Buhariut në *Sahihun* e tij, i cili, gjithashtu, nuk i bëri një hyrje librit të tij, por e filloi me një thënie të Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), pasi libri i Buhariut është libri i traditës profetike dhe dihet se është prej etikës që asgjë të mos paraprijë Allahun dhe të Dërguarin e tij (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Për këtë arsye, autori nuk sjell fjalët e veta para fjalëve të të Dërguarit të Allahut. Buhariu e hap librin e tij me thënien profetike: **"Veprat çmohen sipas qëllimit dhe çdokujt i takon ajo që e ka për qëllim."**¹³ Ai është libër i thënieve profetike. Prandaj autori e nis me fjalët e njeriut që i ka lënë ato thënie (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Ky është prej kuptimeve të holla, të cilat i respektojnë njerëzit zemrat e cilëve Allahu i ka ndriçuar që t'i njohin të drejtat ndaj Tij dhe të drejtat e të Dërguarit të Tij.

¹² Sure DHARIJAT: 56.

¹³ Shënon imam Buhariu, nr: 1. Shënon imam Muslimi, nr: 1907.

Titulli: "Libri i teuhidit"

Në aspektin gjuhësor '*Teuhid*' është paskajorja e foljes "*uehhade*", që do të thotë: "ai njësoi". Kjo fjalë përdoret rrallë në Kuran. Në traditën profetike përmendet: "Thirrja në teuhidin e Allahut", siç përmendet në hadithin e Buhariut, që thotë se, Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), kur dërgoi Muadh Ibn Xhebelin në Jemen, i tha:

"Ti do të shkosh te një popull prej pasuesve të Librit, prandaj le të jetë teuhidi i Allahut gjëja e parë në të cilën ti do të thërrasësh ata!"¹⁴

Kështu, fjala "ju-uahhidu" në hadith është paskajorja e "teuhidit". Ndërsa në një transmetim tjetër të Ibn Abasit, ku përmendet ngjarja e Muadhit në Jemen, në të dy *Sahih-ët*, thuhet se Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i tha:

"Le të jetë gjëja e parë në të cilën do t'i ftosh dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut!"¹⁵

Kjo tregon se *teuhid* është të dëshmosh se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut! Përmbushja e këtyre dy dëshmimeve është përmbushje e teuhidit.

T'i bësh diçkaje *teuhid* do të thotë ta konsideron atë si një, të vetme. Thua për shembull: "*Ueh-hadtu el Mutekel-lime*" (njësova kumtuesin), kur lë vetëm një njeri të flasë.¹⁶ Gjithashtu, "*uehahhade el-muslimune Allah*" do të thotë se "muslimanët e njësuat Allahun", kur ata adhurojnë vetëm një Zot, i cili është Allahu i Madhërishëm.

Teuhidi i kërkuar përmbledh të gjitha llojet e teuhidit të urdhëruara nga Allahu i Madhërishëm në Librin e Tij, e ato janë tre:

1. *teuhidi rububije*,
2. *teuhdi uluhije*,
3. *teuhidi i esmai ue sifat*.

¹⁴ Shënon imam Buhariu, nr: 7372. Shënon imam Muslimi, nr: 19.

¹⁵ Buhariu: 1496, Muslimi, 19.

¹⁶ Shih: Lisan el Arab: 3/450.

- *Teuhidi rububije* është teuhidi i Allahut në veprat e Tij. Dhe veprat e Allahut janë të shumta, si: krijimi, furnizimi, dhënia jetë dhe vdekje, menaxhimi i gjithësisë, sjellja dobi, sjellja dëm, sjellja shërim, marrja në mbrojtje, siç thotë Allahu i Madhërishëm në Kuran: "[Ai mbron, por prej Tij nuk mund të mbrohet askush](#)."¹⁷; përgjigja e lutjes së atij që është në vështirësi të madhe, përgjigja e atij që lutet, dhe veprime të tjera që gjithashtu bëjnë pjesë në teuhidin rububije. Ai i cili kryen këto veprime në mënyrë të plotë, është vetëm Allahu i Madhërishëm. Kështu, teuhidi rububije është njësimi i Allahut në veprat e Tij.
- *Teuhidi uluhije*: Fjala: "*uluhije*" vjen nga folja *elehe, je'lehu, ilaheten dhe uluheten*¹⁸, kur dikush a diçka adhurohet me dashuri dhe madhërim. Thuhet: "*te-el-lehe*", kur adhuron me madhërim dhe dashuri. Ka dallim mes *adhurimit* dhe "*el-uluhe*", pasi "*el-uluhe*" nënkupton adhurim me dashuri, madhërim, të jesh i kënaqur me gjendjen ku ndodhesh, të kesh shpresë, mbështetje, frikë, pra paskajorja e "*elehe, Je'lehu*" është "*ilaheten dhe uluheten*". Ndaj dhe thuhet: *teuhidi ilahije* dhe *teuhidi uluhije*. Që të dyja janë paskajore të "*elehe, je'lehu*".

Kuptim i fjalës "*elehe*" në gjuhën arabe është "adhurim me madhërim dhe dashuri". Edhe "*te-el-luhu*" është adhurimi në atë mënyrë. Poeti Ru'be Ibn Uxhaxh thotë:

"Lil-lahi deru el ganijati mud-deh- sebbahne ues-terxheane min te'el-luhij" (Për Allah, bukuria e saj s'ka nevojë të lavdërohet -Subhanallah, tek Ai do shkojmë dhe me adhurimin tim kënaqësia e Tij dua të fitohet).

Domethënë: "me adhurimin e tij".

Kështu, teuhidi *ilahije* dhe teuhidi *uluhije* është teuhidi i ibadetit (adhurimit), që do të thotë se ky adhurim i dedikohet vetëm njërit, i cili është Allahu i Lartësuar. Adhurimet që bën njeriu janë disa llojesh dhe i Vetmi që meriton të hyjnizohet dhe adhurohet është Allahu i Lartësuar.

Teuhidi *uluhije* është njësimi i Allahut me anë të veprave të ndryshme të njeriut, të cilat ai i bën me synimin për t'u afruar tek Allahu. Kur besimtari ia dedikon këto vepra adhurimi vetëm njërit, që është Allahu i Madhërishëm, ai konsiderohet njësuës (*muuehhid*). Nëse njeriu këtë teuhid ia kushton Allahut,

¹⁷ EL- MU'MINÛN: 88.

¹⁸ Shih: *Muhtar el Sihah*: 9, dhe: *Taxh el Urus*: 36/320.

por edhe të tjerëve, ai konsiderohet *mushrik* (adhurues i dikujt tjetër përveç Allahut).

- Ndërsa lloji i tretë i teuhidit është teuhidi i "*esmai ue el sifati*", që do të thotë që të besosh se Allahu i lartësuar është një dhe absolut në emrat e Tij, në atributet e Tij dhe askush nuk është i ngjashëm me Të në këto aspekte. Nëse një pjesë e krijesave të Allahut të Lartësuar janë të ngjashëm me Të në disa aspekte të jashtme, në cilësitë e Tij, ata nuk janë të ngjashëm me Të në kuptimin e plotë e absolut të këtyre cilësive, pasi cilësitë e plota dhe absolute i përkasin vetëm Allahut të Madhërishëm.

Shembull: Një krijesë mund të jetë krenare ndërsa Allahu i Lartësuar është Krenari, por krenaria e njeriut është në përputhje me qenien e tij si një krijesë e dobët, e varfër, plot mangësi. Allahu i Lartësuar gëzon krenarinë e pafund dhe absolute. Në këtë mënyrë askush nuk është i barabartë me Të, i ngjashëm me Të. Allahu i Madhërishëm thotë: "[Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha.](#)"¹⁹

Këto janë tri llojet e teuhidit, të cilat Shejhu i përmend në këtë libër. Duke qenë se në shkrimet e mëparshme dijetarët – ata të Sunetit dhe të *Akides* - janë kujdesur të shtjellojnë vetëm dy llojet e teuhidit, të parin dhe të tretin, që janë teuhidi *rububije* dhe teuhidi *esmai ue sifat*, Shejhu këtu nuk i ka trajtuar ato në mënyrë të detajuar. Ai është përpjekur të shtjellojë vetëm atë lloj për të cilën njerëzit kanë më shumë nevojë dhe nuk gjejnë të jetë shkruar shumë. Kjo është edhe metoda e Shejhut. Shkrimet e tij të shumta janë përpiluar sipas nevojës së njerëzve dhe jo për të shtuar libra dhe as për variacion. Ai shkroi për ato gjëra që njerëzit kishin më tepër nevojë dhe nuk shkroi thjesht për të shkruar. Ai shkroi për t'i ftuar njerëzit dhe mes këtyre dy gjërave ka dallim të madh. Kështu, në këtë libër Shejhu shtjellon teuhidin *uluhije* apo teuhidin e adhurimit, duke qartësuar njësitë përbërëse të tij, siç janë: mbështetja, frikë-respekti, dashuria, shpresa, dëshira, kërkimi i mbrojtjes, kërkimi i ndihmës, prerja e kurbanit, zotimi për vepra të ngjashme, të cilat duhet t'i dedikohen vetëm Allahut të Madhërishëm dhe askujt tjetër.

Pastaj Shejhu ka shtjelluar atë gjë që është e kundërta e teuhidit - *shirkun*. Ky libër, i cili është libri i teuhidit, shtjellon teuhidin e adhurimit, teuhidin *rububije* dhe teuhidin e *esmai ue sifat*. Ai, natyrisht, trajton edhe atë që është e kundërta e tij, pra shirkun.

¹⁹ ESH-SHÛRA: 11.

Shirk do të thotë të konsiderosh dikë si shok të dikujt tjetër. Në arabisht thuhet: "*Eshrake bejnehuma*", kur diçka e bën dy. Apo: "*eshrake fi emrihi gajrahu*" mori dikë tjetër si ortak në punën e tij, kur çështjen e lë në dorë të dy personave²⁰. Shirku në këtë mënyrë është ortakëri. Dhe Allahu i Madhërishëm e ka ndaluar ortakërinë me Të, siç do të flasim për të, me lejen e Allahut²¹.

Dijetarët, kur kanë folur për shirkun, kanë sqaruar se, nga një këndvështrim, ai ndahet në dy kategori; nga një tjetër në tre kategori. Kështu, ai mund të ndahet në shirk të madh, shirk të vogël dhe shirk të fshehtë; në këtë rast, ai është i ndarë në tri kategori.

Shirk është konsiderimi i dikujt tjetër si ortak me Allahun e Lartësuar në teuhidin e *rububije-s*, në teuhidin e adhurimit, apo në teuhidin e *esmai ue sifat*. Qëllimi këtu është ndalimi i konsiderimit ortak me Allahun e Lartësuar në teuhidin e *rububije-s*, në teuhidin e adhurimit dhe në teuhidin e *esmai ue sifat*, nga njëra anë, dhe urdhërimi i njësimi të Tij - i Lartësuar qoftë! – nga ana tjetër.

Ndarja e parë: Shirku i madh dhe shirku i vogël

Shirku i madh është ai që të nxjerrë nga Bashkësia Muslimane. I vogli është ai, që Ligjvënësi e ka quajtur shirk, por që është një veprim i cili nuk përmban ortakëri të plotë si shirku i madh.

Disa dijetarë e përkufizojnë kështu shirkun e vogël: "Është ai që mund të jetë rrugë për tek shirku i madh". Nisur nga përkufizimi i fundit, shirku i madh mund të jetë i dukshëm, i padukshëm dhe i fshehtë.

Shembulli i shirkut të madh të dukshëm: adhurimi i idhujve, i statujave, i varreve, i të vdekurve dhe i jo të pranishmëve.

Shembulli i shirkut të madh të fshehtë: shirku i atyre që mbështeten tek prijësit e tyre fetarë apo tek zotat e ndryshëm; apo shirku i hipokritëve, pasi hipokritët në brendinë e tyre bien në shirk dhe shirku i tyre është i madh, ndonëse i fshehtë.

Shembulli i shirkut të vogël të dukshëm: Veshja e unazave, e fjongove, varja e hajmalive, betimi jo në emër të Allahut dhe vepra e fjalë të tjera të ngjashme.

²⁰ Shih: "*Lisan el Arab*": 10/450 dhe "*Muhtar el Sihah*": f. 142.

²¹ Shih: f. 50

Shembulli i shirkut të vogël të fshehtë: është syfaqësia e lehtë dhe veprimet e ngjashme me të. Syfaqësia, në bazë të kësaj ndarjeje, është e madhe, siç është syfaqësia e hipokritëve, të cilët Allahu i Madhërishëm i përshkruan: "...Vetëm sa për t'u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak."²² E tillë është edhe syfaqësia e disa besimtarëve, të cilët shtiren në namazin e tyre, me qëllim që t'i shohin njerëzit. Kemi dhe syfaqësinë e vogël, si në rastin e atij që dëshiron ta dëgjojnë dhe ta shohin të tjerët.

Ndarja e dytë: Shirku i madh, shirku i vogël, dhe shirku i fshehtë

Shirku i madh është ai, që të përjashton nga Bashkësia Islame dhe konsiston në dedikimin e një adhurimi dikujt tjetër përveç Allahut të Lartësuar.

Shirku i vogël është ai lloj që është mjet dhe rrugë për te shirku i madh. Në këtë lloj shirku ka prani të ortakërisë që nuk arrin në gradën e ortakërisë që të nxjerrë nga Islami. Ligjvënësi e ka konsideruar shirk bërjen e një veprë të këtillë.

Shirku i fshehtë është syfaqësia e lehtë e të ngjashmet me të. Disa dijetarë anojnë më shumë nga ndarja e parë, kurse disa janë për ndarjen e dytë. Megjithatë, në realitet, të dyja ndarjet janë të njëjta; çdonjëra përputhet me tjetrën dhe nuk ka dallime mes tyre. Nëse dëgjon dikë duke thënë se shirku ndahet në të madh dhe të vogël, kjo thënie është e saktë. Nëse dëgjon dikë tjetër – ky mendim është edhe i prijësve të thirrjes islame - duke thënë se shirku ndahet në të madh, të vogël dhe të fshehtë, edhe kjo gjithashtu është me vend. Nëse është e qartë një e gjë tillë, dije se shirku mund të quhet edhe ortakëri (zota të barabartë), siç thotë Allahu i Madhëruar: "**Prandaj mos sajoni me vetëdije zota të barabartë me Allahun.**"²³ Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), kur është pyetur për gjynahun më të madh, ka thënë: "**Ti bësh Allahut ortak, kur Ai të ka krijuar ty**"²⁴

Ortakëria ndahet në dy lloje: e madhe dhe e vogël. E vogël është ajo që nuk ka dedikim të adhurimit për dikë tjetër përveç Allahut. Në rast se ortakëria përfshin dedikim adhurimi ndaj dikujt tjetër krahas Allahut, konsiderohet e madhe. Nëse i bën ortakëri Allahut në një vepër, e cila nuk e arrin shkallën e shirkut të madh, atëherë ajo konsiderohet e vogël. Ky lloj shirku, pra, quhet i vogël.

²² Sure EN-NISA': 142.

²³ EL-EL-BEKARE: 22.

²⁴ Shënon Buhariu, 4477, Muslimi: 86. Hadithi është i Ibn Mes'udit.

Këto janë disa qëndrime, përkufizime, kujtime, të cilat i përmenda në fillim të shpjegimit tim, për shkak të rëndësisë dhe nevojës së madhe për to. Allahu është më i Dituri.

Prijësi i kësaj thirrjeje - Allahu e mëshiroftë! - thotë: "Libri i teuhidit dhe thënia e Allahut të Madhërishëm..."

Shprehja "**Thënia**" është e ngjashme me atë që u përdor edhe në *Sahihun* e Buhariut. Ajo ose është përdorur si ndajshtim në kuptimin 'Libri i teuhidit dhe i fjalës së Allahut...', domethënë Libri i Fjalës së Allahut..., ose është përdorur si vazhdim në kuptimin '... dhe thënia e Allahut të Madhërishëm'.²⁵

Allahu i Madhëruar thotë: "Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë."²⁶

Ky ajet shtjellon teuhidin. Por, në ç'mënyrë? Selefët,²⁷ fjalën e Allahut të Madhërishëm "**Vetëm që të më adhurojnë**" e shpjegojnë: "Vetëm për të më njësuar Mua"²⁸. Argument për këtë mënyrë shtjellimi është fakti se profetët janë dërguar me mesazhin e teuhidit, pra për teuhidin e adhurimit. Prandaj thënia: "**Vetëm që të më adhurojnë**" domethënë: vetëm të më njësojnë Mua.

Thënia: "Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë." Ky ajet është kufizues, pasi dihet se parafjala "*ma*", kur vjen e shoqëruar me "*il-la*", nënkupton kufizim. Kështu, kuptimi i fjalëve është: Unë i kam krijuar xhinët dhe njerëzit për një qëllim të vetëm, që është adhurimi Im e i askujt tjetër. Ajeti e kufizon shkakun e krijimit të njerëzve dhe xhinëve vetëm për adhurim.

Thënia: "Vetëm që të më adhurojnë". Parafjala "*i-la*" është mjet përjashtues shterues. Ai është përjashtues nga gjendja e përgjithshme, sikurse thonë gjuhëtarët. Dhe kuptimi është: Nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit për diçka apo për një qëllim çfarëdo, kurrësi; i kam krijuar vetëm për një qëllim, që është të më adhurojnë Mua.

Thënia: "Vetëm që të më adhurojnë". "*Lam-i*" në "*li jeabudûn*" (të më adhurojnë) quhet *lam-i* i shkakut, i cili ose shpjegon qëllimin, ose arsyeton qëllimin.

²⁵ Shih: Sahihun e Buhariut: f.56 Libri i guslit dhe f. 64, Libri i hajzit dhe f. 1335, Libri i padive etj.

²⁶ EDH-DHARIJAT: 56

²⁷ Të parët tanë të devotshëm. (shënim i përkthyesit)

²⁸ Shih: *Tefsir el Begaujj*: 4/235.

Lam-i që shpjegon qëllimin. Çfarë vjen pas këtij *lam*-i, duhet të zbatohet. Por, mund të ndodhë kështu dhe mund të mos ndodhë. Këtë *Lam* disa dijetarë e quajnë *Lam*-i i urtësisë. Dallimi mes qëllimit dhe urtësisë shpjegohet në këtë shembull: Nëse thua: “Cili është qëllimi i krijimit të xhinëve dhe i njerëzve?” Përgjigja: “Që të adhurojmë vetëm Allahun dhe asgjë tjetër”. Ky është shpjegimi i fjalës së Allahut "**Vetëm që të më adhurojnë**" dhe ky quhet shtjellimi i qëllimit. Por, nëse pyet dikë: “Përse solle librin?” Ai të thotë: “E solla për ta lexuar”. Këtu kemi të bëjmë me shpjegimin e arsyes së sjelljes së librit, që është për ta lexuar, paçka se ai mund ta lexojë atë ose jo, ndryshe nga *Lam*, i cili shpjegon qëllimin dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në pasojën e qëllimit. Në lidhje me këtë e të ngjashmet me të, dijetarët thonë: Gjykimi kapet pas shkakut, në ekzistencë dhe mosekzistencë. Ky është shkakut i analogjisë, ku pasoja nuk qëndron mbrapa shkakut. Në këtë mënyrë, "*lami*" këtu është '*lami i shkakut*'. Ka krijesa që ekzistojnë, sepse i krijoi Allahu i Lartësuar, por që adhurojnë dikë tjetër. *Lam*-i i urtësisë, është *lam*-i i ligjshmërisë; ajo që vjen pas tij, është e kërkuar në aspektin fetar. Kur Allahu i Madhërishëm thotë "**Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë,**" ne kuptojmë se ky ajet na flet për teuhidin, në aspektin që qëllimi i krijimit është njësimi i Allahut dhe adhurimi këtu ka kuptimin e teuhidit.

Realiteti i adhurimit (aspekti gjuhësor i tij): bindje e nënshtrim. Nëse vishet me dashuri dhe ndjekje, shndërrohet në adhurim sipas konceptit të Sheriatit.

Adhurimi (ibadeti) në terminologjinë e Sheriatit. Zbatimi i urdhrave dhe i ndalesave me dëshirë, shpresë dhe frikë-respekt. Disa dijetarë e përkufizojnë kështu: Ibadeti është gjithçka që është e urdhëruar, që nuk bie ndesh me mendje dhe as s'është pjesë e traditës. Ky është përkufizimi i njohësve të Principeve Islame (usulit).²⁹

Shejhu i Islamit, në letërkëmbimin e parë me titull "El Ubudije³⁰", thotë: Ibadeti është term që përfshin gjithçka që është e dashur për Allahun, qofshin fjalë, qofshin vepra, të dukshme apo të padukshme.

Kështu, ajeti në fjalë na tregon se çdo njësi e adhurimit duhet t'i dedikohet vetëm Allahut dhe askujt tjetër. Kjo pasi, Ai që i krijoi, e bëri këtë me qëllimin që ata ta adhurojnë Atë. Nëse ata adhurojnë dikë tjetër, konsiderohet shkelje dhe padrejtësi e madhe, sepse Ai që krijon, nuk është i barabartë me atë që nuk

²⁹ Shih: "El-Furû" i Ibn Muflih: 1/111.

³⁰ F. 23.

krijon, siç thotë Allahu i Madhërishtëm: "Atëherë, a është Ai njësoj si ai që nuk krijon?!"³¹

Shejhu - Allahu e mëshiroftë! - thotë: "Allahu i Madhëruar thotë: "Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): "Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!"³² Ky ajet shpjegon ajetin e mëparshëm. Ajeti i mëparshëm sqaron kuptimin e adhurimit dhe të qëllimit të krijimit, i cili është përsëri adhurimi. Në këtë qëllim kanë ftuar edhe të dërguarit e Zotit dhe argument për këtë është ajeti kuranor: "Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): "Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!"

Allahu i Lartësuar i dërgoi profetët e Tij (që ta urdhëronin popullin e tyre) me këto dy fjalë: "Adhuroni Allahun" dhe "Shmangni idhujt!" Shprehja "Adhuroni Allahun" nënkupton pohim, ndërsa "Shmangni idhujt!" nënkupton mohim. Ky është edhe kuptimi i teuhidit, i cili konsiston në një pohim dhe në një mohim.

Thënia "Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!" përmban domethënien e shprehjes "La ilahe il-IAllah", pasi pjesa mohuese në të është shmangia e tagutit, që është çdo zot i rremë, i adhuruar padrejhtësisht. Pjesa pohuese e ajetit deklaron se adhurimi duhet t'i kushtohet vetëm Allahut dhe askujt tjetër. Kështu, në fjalën e Allahut "Adhuroni Allahun" kemi të bëjmë me pohim të teuhidit, ndërsa në fjalën e Tij "Dhe shmangni idhujt!" kemi të bëjmë me mohim të shirkut. Taguti është në kategorinë e foljeve "Fealut" dhe buron nga fjala *tug'jan*. *Tug'jan* është çdo kalim i kufirit nga ana e robit në ndjekje dhe në bindje³³ ndaj dikujt tjetër.

Allahu i Madhëruar thotë: "Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuroni asgjë tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit."³⁴

"Zoti yt ka urdhëruar": Sikurse e shpjegojnë disa sahabë, kjo ka kuptimin që Zoti urdhëron e porosin me frymën e këtyre fjalëve, jo me gerat e tyre. Kështu, "en" në thënien (në tekst) "*El-la teabudu!*", është shpjegues. Domethënë, me çfarë ka urdhëruar dhe porosin Zoti? Përgjigjja: Që të mos adhuroni asgjë tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit.

Thënia: "Që të mos adhuroni asgjë tjetër përveç Atij": Ky është kuptimi i "La ilahe il-IAllah", sepse "La" është mohuese në të dyja rastet. Këtu thotë:

³¹ EN-EN-NAHL: 17.

³² EN-EN-NAHL: 36.

³³ Shih: *I'elam el Muuek-ki'ine*: 1/50.

³⁴ Sure ISRA: 23.

“adhuroni”, që është e ngjashme me "ilaha" në devizën e teuhidit. "El ilah" është ai që adhurohet.

"Mos adhuroni asgjë tjetër përveç Atij!": Domethënë adhurimin dedikojani vetëm Atij dhe askujt tjetër, pasi kështu ka urdhëruar Allahu. Ky është kuptimi i teuhidit. Është e qartë që ajeti është tregues i teuhidit, se teuhidi është veçimi i Allahut në adhurim apo jetësimi i "La ilahe il-Allah".

Thënia e Allahut të Madhërishëm "Dhe të silleni mirë me prindërit"
domethënë silluni me bamirësi me të dy prindërit.

Thënia e Allahut të Madhërishëm "Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)!": Këtu gjithashtu kemi të bëjmë me urdhërim dhe ndalim. Urdhërimi është "Adhuroni Allahun", ndërsa ndalimi është "mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)!" Më parë kemi cekur se thënia "Adhuroni Allahun", kur vjen në kontekstin mohues, është tregues i teuhidit. Vështroni me vëmendje ajetin *“mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)!”* "La" këtu është në kontekstin mohues. Është e konfirmuar në shkencën e principeve islame se ndalimi është njëlloj me mohimin, ndërsa, kur vjen para një fjale të pashquar, është gjithëpërfshirës³⁵. Dhe këtu fjala që vjen pas "la", është e pashquar, që është paskajore dhe një nga treguesit e foljes, pasi folja në kohën e tashme përmban paskajoren dhe kohën. Kështu, "La tushriku" (mos i shoqëroni) domethënë: Jo ortakëri. Togfjalëshi "La tushriku" përfshin paskajoren dhe paskajorja është e pashquar. Në këtë mënyrë, thënia "La tushriku" (mos i shoqëroni) ndalon të gjitha llojet e shirkut. Sikurse edhe thënia "shej'en" (gjë) në ajet, që është në formën e pashquar dhe përfshin ndalimin e të gjitha gjërave. Në këtë mënyrë, në thënien e të Madhërishmit **"Dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)!"** gjejmë dy përgjithësime:

- Ndalimi i të gjitha llojeve të shirkut, pasi parashtesa mohuese "la" është vendosur para një foljeje, që është treguese e paskajores, dhe paskajorja është e pashquar.
- Pësorja e "Tushrik" është "shej'en" (diçka), dhe është e pashquar në një kontekst mohues. Kjo tregon përgjithësimin e gjërave, çka nënkupton se nuk është i lejueshëm as shirku i vogël, as i madhi dhe as i fshehti. E gjitha kjo përftohet nga ajeti *“La tushriku bihi shej'en”* (mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)!)

³⁵ Shih: Irshad el fuhul: 1/532 dhe Mudhekiratun fij Usul el fih: f. 364.

Po ashtu nuk është e lejueshme që Allahut t'i shoqërohet ndonjë engjëll, profet, njeri vepërmirë, vepërkeq, i ditur, i afërm, i largët. E gjitha kjo përftohet nga fjala "*shej'en*" (diçka). Kjo argumenton qartë teuhidin, duke bërë bashkë mohimin dhe pohimin.

Thënia e Allahut të Madhërishëm: "Thuaju: "Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); të silleni mirë me prindërit; të mos vrisni fëmijët tuaj, për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata; të mos u afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta a të fshehta, dhe të mos ia merrni tjetrit jetën të cilën Allahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia (e ligji). Kështu ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni. Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijë pjekurinë! Kryejeni drejt matjen dhe peshimin; Ne nuk ngarkojmë asgjë përtej mundësisë së tij! Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj! Plotësoni besën e dhënë Allahut! Kështu ju porosit Ai, që të mos harroni. Kjo është rruga Ime e drejtë, prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera, që ju shmangin nga rruga e Tij. Kështu ju porosit Ai, në mënyrë që të ruheni nga të këqijat."³⁶

Thënia e të Lartmadhërishmit: "Thuaju: "Ejani..." domethënë: O ju që keni ndaluar disa mirësi dhe - në këtë mënyrë - keni trilluar në emër të Allahut: "Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)". Dijetarët thonë se "*enne*" (që të) është shpjeguese. Objekti i shpjeguar është hequr dhe mendohet të jetë "ju ka porositur", pasi parafjala shpjeguese "*enne*" është ajo që vjen pas një fjalie e cila kuptohet nga fryma e fjalës dhe jo nga shkronjat e saj. Është përcaktuar se pjesë e hequr është "ju ka porositur..." pasi kjo fjalë gjendet në fundin e ajetit ku thuhet: "Kështu ju porosit Ai, në mënyrë që të ruheni nga të këqijat." Ndërsa në ajetin e dytë thotë: "Kështu ju porosit Ai, që të mos harroni." Dhe në ajetin e tretë: "Kështu ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni." Në të tria këto ajete përmendet fjala "porosi", ndaj dhe ajo që kuptohet nga fjalia është: "Thuaju: "Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka porositur Allahu: Ai ju ka porositur që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)", domethënë: Ju ka urdhëruar. Porosia këtu është shariatike, e, kur është e tillë, është një urdhër i detyrueshëm për t'u zbatuar.

"Dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)". Ky ajet është tregues i teuhidit po aq sa ishte edhe ajeti i sures EN-NISA' përpara tij³⁷.

³⁶ EL-EN'AM: 151-153.

³⁷ EN-EN-NISA': 36, f. 11.

Pastaj Shejhu (Allahu e mëshiroftë!) përmend thënien e Ibn Mesudit: "Kush dëshiron të shikojë testamentin e Muhamedit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), me të cilën ai mbylli jetën e tij, le të lexojë thënien e Allahut të Madhërishëm..."

Thënia "Me të cilën ai mbylli jetën e tij" domethënë: porosia e fundit që ai la, gjëja e fundit që urdhëroi. Nëse supozojmë se ai ka lënë një testament të vulosur, i cili do të hapej pas vdekjes së tij (Paqja e Allahut dhe begatia e Tij qofshin mbi të!) dhe kalimit pranë Shoqëruesit të Lartë, atëherë testamenti do të ishin këto ajete, të cilat përmbajnë dhjetë porosi. Kjo thënie e Ibn Mes'udit tregon për rëndësinë e madhe të këtyre ajeteve, të cilat filluan me ndalimin e shirkut. Profeti (Paqja e Allahut dhe begatia e Tij qofshin mbi të!) thirrjen e tij e nisi me urdhrin për të adhuruar një Zot të vetëm dhe për ndalimin nga shirku dhe gjithashtu e përfundoi - siç mësohet edhe nga fjalët e Ibn Mes'udit - me urdhrin për njësim të Allahut dhe ndalimin nga shirku. Kjo tregon epërsinë, përparësinë dhe rëndësinë e këtyre dyjave mbi gjithçka tjetër.

Pastaj thotë: Muadh Ibn Xhebeli tregon: "Isha hipur së bashku me Profetin - paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! - mbi gomar, kur ai më tha: "O Muadh, a e di se cila është e drejta e Allahut ndaj robërve të Tij dhe e drejta e robërve ndaj Tij?" Unë i thashë: "Allahu dhe i Dërguari Tij e dinë më së miri". Ai tha: "E drejta e Allahut ndaj robërve është ta adhurojnë dhe të mos i bëjnë shok asgjë, ndërsa e drejta e robërve ndaj Allahut është që të mos i dënojnë ata që nuk i bëjnë shok asgjë".

Pjesa argumentuese në këtë hadith është thënia: "E drejta e Allahut ndaj robërve është ta adhurojnë dhe të mos i bëjnë shok asgjë." Ndërsa kuptimi i hadithit është shpjeguar më parë.

Përshtatshmëria: Fillimi i Librit të teuhidit, që fillon me "*Hakku*" (e drejta), ndërsa në hadith: "A e di se cila është e drejta e Allahut ndaj robërve të Tij?" Pastaj tha: "E drejta e Allahut ndaj robërve është ta adhurojnë dhe të mos i bëjnë shok asgjë". Kjo e drejtë është e detyrueshme ndaj Allahut të Madhërishëm. Kjo pasi Kurani dhe Suneti, madje edhe të gjithë të Dërguarit, erdhën me këtë të vërtetë dhe me sqarimin e saj, sepse kjo është detyra parësore e krijesave.

Pastaj thotë: "Ndërsa e drejta e robërve ndaj Allahut është që të mos i dënojnë ata që nuk i bëjnë shok asgjë".

"Ndërsa e drejta e robërve ndaj Allahut..." do të thotë këtë të drejtë Allahu ia ka detyruar Vetes së Tij - siç është mendimi i të gjithë dijetarëve - apo ia ka

vendosur Vetes si detyrë, siç shprehen një pjesë tjetër e dijetarëve, ndër të cilët edhe shejh Tekiju el-Din Ibn Tejmije.³⁸

E drejta e përmendur në hadith "Ndërsa e drejta e robërve ndaj Allahut..." - a është detyrim për të, apo jo?

Përgjigjja: Po, është një detyrim për të, por një detyrim që vetë Ai ia ka ngarkuar Vetes së Tij, pasi Allahu i Lartësuar, në përputhje me urtësinë e Tij, mund t'i ndalojë vetes ç'të dëshirojë dhe t'ia detyrojë Vetes ç'të dëshirojë, sikurse ia ka ndaluar Vetes padrejtësinë, kur thotë: "Unë ia kam ndaluar Vetes padrejtësinë dhe e kam bërë atë të ndaluar mes jush, prandaj mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit!"³⁹ Po ashtu, Ai i ka bërë të detyrueshme Vetes së Tij edhe gjëra të tjera. Megjithatë, disa dijetarë nuk kanë preferuar ta përdorin këtë mënyrë të të shprehurit, duke shtuar se më mirë është të thuhet: është një e drejtë që Zoti ka mirësinë ta përmbushë mbi kë të dëshirojë. Kjo është një e drejtë mirësie dhe jo e drejtë detyruese. Sidoqoftë, një gjë e tillë nuk është patjetër e domosdoshme, pasi e drejta detyruese është ajo të cilën vetë Zoti ia ka ngarkuar Vetes së Tij, kurse njerëzit nuk mund t'i ngarkojnë detyrime Zotit të Lartësuar. Pra, është Ai që ia ka bërë të detyrueshme këtë vetes së Tij si dhuratë për robërit e Tij. Dhe, sigurisht, Allahu i Lartësuar nuk thyen premtimin e dhënë.

³⁸ Shih: Mexhmu'u el Fetava: 1/340.

³⁹ Shënon Muslimi: 2577, hadithi është nga Ebu Dheri (Allahu qoftë i kënaqur me të!).